

STILISTIKA E MJETEVE FONETIKE DHE MORFOLOGJIKE NË VEPRAT E KADARESË

STYLISTICS OF PHONETIC AND MORPHOLOGICAL TOOLS IN KADARE'S WORKS

Hana DARDHISHTA¹

¹*Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*}*Corresponding author e-mail: hana.dardhishta@unite.edu.mk*

Abstract

In addition to being a very complex and refined language, the language used in Kadare's works finds its primary source of support in everyday speech. The reader himself is the greatest person to witness this. The reader—or, more accurately, the researcher—is the one who is most familiar with the fact that Kadare's works employ not only literary language but also dialectal forms and novel word formations, which occasionally impart stylistic or semantic nuances that differ from those of the standard language word. Thus, he is among the authors who have contributed to the expansion of the lexicon through the addition of new terms and forms. Similar to any other language, Albanian stylistics examines the Albanian language's instruments and expressive potential as well as its discourse structure, styles, and texts from the perspective of secondary linguistic organization.

Older words, neologisms, and regionalisms are examples of words with evocative power that can be employed as stylistic elements to give a text or style the right nuances. This research paper's goal was to discuss the stylistic elements found in Ismail Kadare's "Broken April" and "The Fall of the Stone City" books and novels. These elements included phonetic organization—that is, combining words to create a perceptible expressive effect—sound symbolism, word formation as a stylistic element, and word-forming methods. We also include the presentation or samples from Kadare works in the paper's thorough section. Suffixation and composition take center stage in this paper among the novel word-forming methods in terms of production and extension.

Keywords: *Kadare, stylistics, sound symbolism, word formation.*

Përmbledhje

Gjuha e veprës së Kadaresë përveç se është një gjuhë shumë e përpunuar dhe e ngritur, është një gjuhë që si mjet shprehjeje, mbështetjen kryesore e ka tek e folura e popullit. Këtë më së miri e dëshmon vetë lexuesi. Lexuesi ose, më mirë thënë, studiuesi i Kadaresë është ai i cili e di mirë se nuk është vetëm gjuha letrare e përdorur në veprën e tij, por duke përfshirë këtu edhe format dialektore, gjithashtu edhe fjalëformimet e reja, të cilave në të shumtën e rasteve u jep ngjyrimet stilistike ose nuancë kuptimore të ndryshme nga fjala e gjuhës standarde. Pra, është njëri nga shkrimtarët që gjithashtu ka ndikuar edhe në pasurimin e leksikut me fjalë e forma të reja. Stilistika e gjuhës shqipe, si ajo e çdo gjuhe tjetër, i studion mjetet e mundësitë shprehëse të shqipes, sistemin e stileve e të ligjëtimeve dhe tekstet shqipe nga pikëpamja e organizimit gjuhësor dytësor.

Për stilistikën, fjalët e vjetruara, neologjizmat, krahinorizmat janë fjalë që kanë një aftësi evokuese, që mund të shfrytëzohen si vlerë stilistike, duke ia dhënë kështu ngjyrimin përkatës stilems ose tekstit. Qëllimi i këtij punimi studimor ka bërë që të përfshijmë karakteristikat stilistike në veprat "Prilli i thyer" dhe "Darka e gabuar" të Ismail Kadaresë, duke përfshirë organizimet fonetike (pra përbërësit tingullorë, duke i ndërthurur fjalët që të bëhen të perceptueshme për efekt shprehës), simbolizmin tingullor, gjithashtu edhe fjalëformimin si element stilistik, si dhe identifikimin e mënyrave fjalëformuese. Në pjesën shtjelluese të punimit e kemi edhe paraqitjen ose shembujt nga veprat e Kadaresë. Nga mënyrat e reja fjalëformuese për nga prodhimtaria dhe shtrirja në këtë punim vendin kryesor e zë prapashtesimi dhe më pas, kompozimi.

Fjalë kyçe: Kadare, stilistikë, simbolizëm tingullor, fjalëformim.

Hyrje

Profili i shkrimtarit të njohur Ismail Kadare është i njohur për botën shqipfolëse. Për vlerat letrare dhe artistike të Kadaresë është shkruar e folur shumë. Stili dhe formësimi gjuhësor i këtij mjeshtri të madh të letrave shqipe, e sidomos mjeshtëria e tij në lëmin e fjalorit bën që lexuesi gjithmonë të mbetet i mahnitur apo i befasuar. Edhe pse ai shkruan në gjuhën standarde, që do të thotë se u përmbahet normave drejtshkrimore dhe gramatikore të shqipes së sotme, megjithatë kjo nuk e pengon aspak për të shprehur veçantitë e tij gjuhësore.

Çdokush që i lexon veprat e Kadaresë medoemos do ta kuptojë që është një:

- shoshitës i paepur i leksikut të shqipes;
- fjalëkrijues i veçantë, pra përpunon e rikrijon fjalë;
- përtëritës i kuptimeve dhe përdorimeve të fjalëve të njohura;
- rigjallërues i fjalëve të moçme të trevave veriore etj.

Gjatë analizës vëmë re që kemi shumë fjalë, togfjalësha, fjali thirrmore, formulime, përtëritje fjalësh të vjetra të cilat i referohen së njëjtës dukuri që lidhen me kodin zakonor shqiptar, që njëherit është edhe një nga shenjat identifikuese më të moçme e të dallueshme të kombit, siç është Kanuni. Pra, çdo gjuhë lidhet me një shoqëri, qytetërim, kulturë e mendësi të dhënë meqenëse ajo përcakton një këndvështrim origjinal të realitetit. Kështu ndodh edhe me gjuhën e veprave *Prilli i thyer* dhe *Darka e gabuar*, që njëherit është edhe objekt trajtimi i temës tonë.

Në analizën tonë më poshtë do të përfshijmë edhe ngjyrimet subjektive të vetë fjalëve. Sipas studimeve të Xhevat Lloshit, ngjyrimet subjektive lindin nga marrëdhënia vetjake e ligjëruesit me objektin e bashkëbiseduesin. Një emër abstrakt mund të përdoret si konkret, një jofrymor si frymor, një emër veprimi si emër rezultati të veprimit dhe anasjelltas, p. sh. në prozën e Kadaresë ndeshen shpesh sendëzime të gjendjeve psikologjike (*hutimi, trishtimi, lumturia*), personifikime të mendimeve, përdorimi në togje i emrave abstraktë dhe të veprimit si emra konkretë (Lloshi, 2001: f. 67).

Karakteristikat stilistike

Për stilistikën fjalët e vjetruara, neologjizmat, krahinorizmat janë fjalë që kanë një aftësi evokuese, që mund të shfrytëzohet si vlerë stilistike, kështu duke i dhënë ngjyrimin përkatës stilems ose tekstit. Që vlera e saj dialektore të luajë rolin e ngjyrimit stilistik duhet të përfshihet në një kontekst tjetër, p. sh.: për fjalën *shaka* kemi edhe një trajtë tjetër *mahi* (mahitem), *Ti mahitesh me mua. Nuk mahitem Fritz.* (Kadare, 2015: f. 54). Te Kadareja trajta *mahit* i jep ngjyrimin tekstit, përçon një informacion plotësues: jemi në një kohë historike, pra ka të bëjë me lëndën që zgjedh dhe përdor ai, me hapësirat prej nga vijnë prurjet leksikore. Gjithashtu edhe shprehja apo më mirë thënë përemri në fjalinë në vijim është një stilizim dialektor: *Dhe, siç të thashë, kur mora urdhrin ta pushtoj...domethënë ta...bashkoj Shqipërinë, mendimi i parë ishte, do shkoj te vëllai i em. Do ta gjej kudo që të jetë.* (Kadare, 2015: f. 47).

Siç shohim shprehja lidhet me kohën, me të menduarit dhe të folurit e një të huaji që kishte dëgjuar aq shumë për Kanunin e Lekë Dukagjinit nga shoku i tij shqiptar. Pra, vlera stilistike varet nga vendi në sistemin e gjuhës, ndërsa karakteristika stilistike mishërohet në kontekst.

Organizimet fonetike

Në veprat e Kadaresë dalin në dukje edhe anët e sistemit tingullorë apo përbërësit tingullorë, kjo duke ndërthurur fjalët që të bëhen të perceptueshme këto anë për efekt shprehës dhe sidomos për bukurtingëllim por gjithashtu edhe për muzikalitet. Organizimet e tilla fonetike çojnë te një orkestrim tingullor i thënieve, që kthehet në tingëllim të afërt të gjymtyrëve të ndryshme (paronomazia). Këtë aspekt stilistik do ta tregojmë nëpërmjet shembullit në vijim: *Shubertë e sherbete*, p. sh.: *E kur të tjerët i ktheheshin për t'i thënë se s'bëhej fjalë për atë gërdallë të Luftës së Parë Botërore, por për Shubertin, e di Shubertin ti, ai zemërohej. Ik, ore tutje, me gjithë ata Shubertë e sherbete, të gjitha janë profka...* (Kadare, 2015: f. 35). Pra, janë dy fjalë me kuptime tepër të largëta, por shumë të afërta si tingëllim.

Simbolizmi tingullor

Lidhja ndërmjet tingullit dhe kuptimit jep një burim shprehësie, përndryshe tingujt e veçuar nuk bartin kuptim. Në sistemin e gjuhës shqipe ka disa modele që marrin vlerë për kategori të ngushta fjalësh, e të cilat i hasim edhe te veprat e Kadaresë, si p. sh., dhëmboret e grykoret përdoren për të treguar trokitjet, si: *trik-a-trakun*, p. sh. *...ndonëse gjithkush ia ndiente trik-a-trakun, kurrkush s'e dinte ku ndodhej*. (Kadare, 2015: f. 29-30). Madje ka edhe fjalë të tilla, të cilave nuk ua dimë kuptimin, por nga tingullimitimi na ngjallin një përshtypje ose ndjenjë me tingëllimin e tyre, si: *tërçi e vërçi, tralala* (Kadare, 2015: f. 96) p. sh. *...akoma beson përralla të tilla se gjermani e doktori qenkëshin shokë shkollë, e tërçi e vërçi e tralala...*

Tingullimitimet shërbejnë për të imituar tinguj, zëra, zhurma, britma, klithma etj. të sendeve dhe dukurive të ndryshme të realitetit objektiv, si: *ah, uf*, etj. e prej të cilave Kadareja formon fjalët *ufma* e *ahme* si, p. sh. *...kështu që s'kishin kohë për ufma e për ahme, por për këtë ishte mirë të pyeteshin mjekët e dergjave të gjata...* (Kadare, 2015: f.105). Për të riprodhuar të njëjtin tingull, zë, zhurmë, britmë, klithmë etj. të një sendi a dukurie të dhënë, përdoren, në mjaft raste, tingullimitime me përbërje të ndryshme tingullore, si në shembujt në vijim: *firifiu* (Kadare, 2015: f. 59), *turuluja* (Kadare, 2015: f. 58), *tyryfyl* (Kadare, 2015: f. 13) etj. Po kështu ndodh edhe me tingullin *ç*, i cili për shqiptarët jep përshtypjen e zvogëlimit, si p. sh. *birucë* (Kadare, 2015: f. 142), *dhëmbec(in)*, *mbërtheckë* (Kadare, 2003: f. 166), *picërr* (Kadare, 2003: f. 149) etj. Kështu kuptojmë që ndjenja gjuhësore kudo kërkon një kuptim.

Fjalëformimi si element stilistik

Duke u nisur nga vetë elementet fjalëformuese që gjatë krijimit të fjalëve të reja, disa prej tyre automatikisht fjalës i japin një ngjyrim stilistik dhe kjo veshje stilistike e tyre arrihet edhe nëpërmjet ndajshitesimit.

- Parashitesimi si element stilistik: në këtë model fjalëformimi hyjnë fjalët me parashtesën, *ç-/sh-/zh-* të cilën e gjejmë te Kadareja, i cili duke shtuar qoftë edhe një parashtesë, mund të japë nuanca ngjyre, pamje, ndjenjë, si p. sh. *çngjyroseshin* (Kadare, 2003: f. 54), *çngurosja* (Kadare, 2003: f. 71), *çheroizim (vetëçheroizoheshin)*, *shtrajtuar, shtrajtoheshin* (Kadare, 2015: f. 16, 56), *zhdehës, zhburrohesh, zhbirime* (Kadare, 2003: f. 99, 53, 154) etj.
- Prapashtesimi si element stilistik: Një përftesë tjetër me fjalëformimin tek e cila përzihen më shumë elemente stilistike është prapashtesa *-shëm*, e përdorur aq dendur nga Kadareja për të krijuar jo vetëm mbiemra të nyjshëm, por edhe një numër të madh ndajfoljesh. Pra, si vlerë stilistike llogariten edhe ndajfoljet me prapashtesën *-shëm*. Ato dalin që te Buzuku

(përmishëriershim), që duhet thënë se janë të zakonshme në dialektin e gegërishtes. Të tillë shembuj kemi edhe në veprat që i kemi si lëndë për analizë, si p. sh. këmbëngulshëm, pikëllueshëm etj. (Kadare, 2015: f. 198, 50), hareshëm, përbuzshëm etj. (Kadare, 2003: 29, 116). Ndajfolja pikëllueshëm, në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe nuk del si mbiemër, por është mbiemri i nyjshëm 'i pikëlluar'. Pra, vjen prej pjesores geqe që kryesisht shërben për ndërtimin e mbiemrave të këtij tipi. Megjithatë, sistemi i gjuhës shqipe nuk e përjashton ndërtimin e një mbiemri, prej të cilit, me konversion përftohet ndajfolja. Edhe ndajfolja këmbëngulshëm, në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe nuk del si e tillë, por del këmbëngultas, pra kjo formë vjen nga prapashtesa -shëm që është e zakonshme për gegërishten. Këto krijime ndajfoljore (e që janë të shumta në veprat e Kadaresë) janë nuanca kryesore dhe element kryesor stilistik i Kadaresë.

- Prapashtesën -shëm e kemi si vlerë stilistike edhe te mbiemri i fundbotshëm (Kadare, 2003: f. 149). Në fjalor nuk gjendet as forma i botshëm dhe as kompozita fundbotë, pra, siç duket kemi të bëjmë me një formim parasintetik, kjo nga sintagma 'fundi i botës'. Por, nuk duhet harruar të përmendim se gjuha shqipe si model fjalëformues ka fjalën i përbotshëm. I njëjti shembull na del edhe si: e fundbotshme, p. sh. Hamendja se mund të gdhinte një ditë e tillë, Mark Ukaçjerrës i dukej e fundbotshme. Shembuj të tjerë të cilat i gjejmë në po të njëjtën vepër janë: gëzueshëm, ngatërrueshëm, përbuzshëm etj. (Kadare, 2003: f. 191, 171, 116). Këto ndajfolje të mënyrës të cilat i gjejmë edhe në fjalor janë ndërtuar me konversion prej mbiemrit i gëzueshëm, i ngutur, i përbuzur etj.
- Trajatat e shumësit të emrave në shqipe kanë larmi të madhe, edhe pse njëra trajtë zakonisht vendoset si më normative dhe asnjane, të tjerat marrin ngjyrimë përcmuese e ironike. Tashmë shumë emra mund të ndërtojnë një shumës me prapashtesën -ra, duke marrë ngjyrim shpërfillës, të tillë shembuj kemi edhe te veprat e Kadaresë, si: copëra(t), frikëra etj., p. sh: Druri i saj ishte brejtur kudo dhe midis asaj brejtjeje dukeshin gjithfarë koka gozhdësh e copëra hekurash të ngulura... (Kadare, 2003: f. 62); Ishte guva që ndillte ato frikëra (Kadare, 2015: f. 162).
- Jashtë vëmendjes nuk mund të mbetnin edhe prapashtesat tjera, siç janë ato që shprehin kuptime zvogëlimi ose përkëdheljeje. E veçanta e krijimeve të reja me po këto prapashtesa, është fakti se Kadareja formon stilema me funksione artistike, sidomos ato me prapashtesën -th, p. sh. hamendth(i), katundth(e), vagëllimth (i), rrëshqanth(i), qytetth(i) (Kadare, 2003: f. 60, 42, 14, 35, 221); vetëtimthi (Kadare, 2015: f. 151), vogëlth (Kadare, 2015: f. 31), jetimth(a) (Kadare, 2015: f. 179), por nuk mungojnë edhe shembujt me prapashtesat -ëz, si, p. sh. arrëz(ën) (Kadare, 2015: f. 141), dritëz, dhëmbëz(at), flakëz(at), mollëz(a), njollëz(a), pakëz, pikëz(a), qafëz(ën), rrotëz(at). (Kadare, 2003: f. 134, 85, 57, 174, 107, 154, 123, 107, 160).
- Në fushë të stilistikës zë vend edhe përdorimi i gjerë i emrave prejfoljorë me prapashtesën -im, dhe e veçanta e tyre është edhe kuptimi i ri që marrin, si: pikëshikim (Kadare, 2015: f. 77), pastaj pleqësim(esh) (Kadare, 2003: f. 118), apo shembuj të sendëzimeve psikologjike, si: hutim, trishtim etj. Për formimin e disa emrave të përgjithshëm të vendeve përdoret edhe prapashtesa -ishte, si: ferrishte, katundishte, zallishte (Kadare, 2003: f. 217, 107, 192) etj.
- Emrat e përveçëm prej kohësh u janë nënshtruar përfitesave shprehëse në letërsinë tonë. Kështu edhe në analizën tonë kemi rastisur në emërtime, si: krushkapari, motërvetmja, qehajajushka, setërkatorshi, vëllavogli, (Kadare, 2003: 35, 159, 110, 84), veshkori, apendicitsi (Kadare, 2015: 92, 93). etj. Një emër jofrymor kalon në emër frymor dhe në të shumtën e rasteve këto emërtime në veprat letrare bëhen element stilistik, p. sh. Sipas veshkorit, kishin ndodhur gjëra të rëndësishme në qytet, madje edhe në pavijon...; Na e bëre mendjen dhallë, tha apendicitsi. (Kadare, 2015: 92, 93).

- Përemrat nuk kanë larmi të trajtave, megjithatë janë të pranishme variantet krahinore apo dialektore, si: asosh, syresh etj., p. sh. Kishte atje novela, drama dhe gojëdhëna..., por kishte dhe asosh, të hidhura helm, që s'merrej vesh... (Kadare, 2003: f. 141); Ata shkuan aq larg, saqë të ngulnin këmbë se breshëritë e mitralozave ishin ndërthurur përnjëmend me muzikë, madje disa syresh thoshin se... (Kadare, 2015: f. 32).
- Në formimin e mbiemrave ka edhe një varg elementesh që kanë marrë rrugën e parashtesave, pa përfunduar plotësisht të tilla. Këto quhen siparashtesa ose prefiksoide, si: gjysmëterr, gjysmëmitik (fjalë të cilat nuk i gjen dot në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, që d.m.th. janë fjalë të reja të krijuara nga Kadareja, por që sipas formimit të mbiemrave në gjuhën e sotme letrare përputhen plotësisht). Gjithashtu kemi raste ku mbiemrat e përbërë, elementi i dytë i të cilëve është një emër, a një mbiemër me prapashtesën -sh, si fjalëkrijimet, p. sh. dynetshi, trirrotësh(i, at) etj. (Kadare, 2015: f. 27, 40).

Kompozimi stilistik

Kur vjen fjala për kompozitat e Kadaresë, ato janë të shumta, përfshirë këtu kompozitat e kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore. Pra, kompozitat e Kadaresë janë shtylla tjetër kryesore e fjalëkrijimit të tij, si p. sh.

- *brezftoht, fortashtrojë, fundshtrojë, gjysmëmitik, gjysmëterr, kryeqyqe, mendjefyell, pajambajtës(it), parakënge, paravaji, prillmort, setërkatorshi, turravrap, ujëbardha* etj. (Kadare, 2003: f. 44, 165, 43, 200, 68, 18, 82, 113, 180, 27, 110, 14, 189).
- *bjerrakohësve, fajkërkues, fajshpërndarës, grarrëmbyes, karaputanë, messhtatori, nënpullazeve, njëshkolonë, pikëshikim, trirrotësh* (Kadare, 2015: f. 83, 121, 25, 18, 80, 27, 69, 95, 77, 40).

Karakteristikat fjalëformuese me kompozim

- *Kompozitat me marrëdhënie bashkërenditëse (këpujore)*

Në gjuhën shqipe, siç e dimë bashkimi i temave në një fjalë të vetme të përbërë, rregullisht bëhet pa ndërmjetësimin e zanoreve lidhëse o/a. Kompozitat me zanore lidhëse janë shumë të pakta, por që funksionojnë në gjuhën shqipe dhe po shtohen gjithnjë e më tepër. Edhe gjatë analizës së këtyre veprave, hasëm në shembujt në vijim, si: *bjerrakohësve* (Kadare, 2015: f. 83), *fortashtrojë turravrap* etj. (Kadare, 2003: f. 217, 14).

- *Kompozitat me marrëdhënie nënrenditëse (përcaktore)*

a) Kompozitë të përbërë nga një numërorë + një emër, si: *njëshkolonë*, p. sh.: Njerëzit ngriheshin që pa gdhirë, shpalosnin një flamur dhe niseshin në *njëshkolonë* për të mihur. (Kadare, 2015: f. 95).

b) Kompozitë të përbërë nga dy tema emërore, p. sh.: *kryeqyqe, prillmort, setërkator* etj.

c) Kompozitë të përbërë nga një emër + një emër prejfoljor veprimi, ku gjymtyra e parë përcakton të dytën duke i shërbyer asaj si objekt veprimi, p. sh.: *fajkërkues, fajshpërndarës, grarrëmbyes* etj.

ç) Kompozita të formuara nga një emër dhe një mbiemër, p.sh.: *brezftoht, ujëbardh* etj.

d) Kompozitë e formuar nga një mbiemër dhe një emër, nga fjalë të huaja, që tanimë gjejnë përdorim herë pas here te folësit shqiptar dhe përdoret me kuptim ofendues apo sharje, p.sh.: *karaputanë (kara+putanë)*, p. sh.: *Të lojta dhe të humba, moj skrofë, moj karaputanë*. (Kadare, 2015: f. 80).

- *Karakteristikat fjalëformuese me mënyrat e përziera në gjuhën shqipe:*

Tipin e përzier kompozim + ndajshitesë, *nënpullaze(ve)*: nën + pullaz + e, p. sh.: ...*në trenjtë e nënpullazeve e...* (Kadare, 2015: f. 69). Në romanet e Kadaresë kemi edhe fjalëformime të reja, si: *fundshtrojë*, që në fjalor nuk e kemi këtë fjalë dhe që si sinonim i saj është fjala *dysHEME*, p. sh. *Ndërsa po ulej në një nga ndenjset, Gjorgu ndjeu tytën e pushkës t'i prekte fundshtrojën dhe e hoqi nga supi* (Kadare, 2003: f. 43); *Të gjithë ngrinë në vend, dhe sytë, dhe qafat...për t'u përplasur me forcë në dërrasat e fundshtrojës, u ulën...* (Kadare, 2003: f. 56). *Poshtë, nën fundshtrojë, dëgjohej bërlykja e një kau.* (Kadare, 2003: f. 96).

Gjithashtu do të hasim edhe disa fjalëformime të tjera që nuk i gjen dot në fjalor, kemi kompozitën parafjalë + emër, si: *messhtator* (Kadare, 2015: f. 27), *paravaj(i)*, *parakënge* etj., (Kadare, 2003: f. 180), ku në të shumtën e rasteve *para* na del si fjalëformim, si pjesë e parë e fjalëve të përbëra e të përngjitura, që u përgjigjet kuptimeve të ndajfoljeve *përpara* e *para* dhe shërben për të formuar: emra, mbiemra, folje, ndajfolje. Këto shembuj të fjalëformimeve dhe shumë e shumë shembuj të tjerë janë për t'u studiuar dhe njëkohësisht edhe për t'u vlerësuar gjuhësisht.

Pra, edhe kjo është një vlerë tjetër në veprat e tij madhore. Shembuj të tjerë të fjalëve të reja të cilat e pasurojnë leksikun e gjuhës shqipe, të cilat fjalë gjithashtu nuk i gjen dot në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, janë si në vijim: *arkëmorte, bubuzharë, hekuremtë, hirnosje, humnerohë, kotsëkotshme, kuçedërshme, pjerrtazi, rindizte, rrëshqitazi, shtrembtazi, shurdhtazi, zotynë* etj. (Kadare, 2003: f. 158, 68, 64, 75, 80, 86, 150, 181, 52, 62, 56, 162). Gjithashtu kemi potencuar më lartë që Kadareja shquhet për prurjet e fjalëve krahinore e dialektore, herë pas here shoqëruar edhe me një përtëritje apo shndërrim të kuptimeve dhe të mjeteve fjalëformuese të tyre. Pra, vihet re një etje e Kadaresë për fjalë të trevave veriore. Në vijim kemi dhënë shembuj, si: *asosh, besëshkelës, bishtcung, bujtësit, bujtnin, çeltina, çuriste, dorëras (nga doras), gjithshkafjes, hijerina, krillave, kushedisatën, lëçitje (veçim), marrokë, mirëfilltas* etj. (Kadare, 2003: f. 141, 50, 102, 96, 95, 157, 59, 56, 59, 172, 27, 157, 51, 82, 128).

Përfundim

Sa i përket fjalësit të veprave të Kadaresë vijmë në përfundim se në prozën e tij ka shumë fjalë të cilat nuk gjenden në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe. Kështu duke i dhënë gjuhës sonë një numër të madh fjalësh që do t'i quaja 'të veçanta', Kadareja në mënyrë të tërthortë na tregon bindjen e tij apo besimin që gjuha shqipe është një gjuhë e gjallë dhe e pasur, pavarësisht sundimeve të gjuhëve të tjera gjatë epokave të ndryshme dhe dinamikave të kohës së sotme, ajo vazhdon të mbetet e tillë. Përdorimi i shtresës së vjetër leksikore e bën ligjërimin e tij më të gjallë, më bindës e më të vërtetë. Kadareja mbetet mjeshtër në krijimin e fjalëve të reja, si njësi të reja leksikore, por edhe si njësi ekzistuese që mbartin kuptim të ri.

Organizimet fonetike, siç e pamë nga shembujt e mësipërm, çojnë te një orkestrim tingullor i thënieve, që kthehet në paronomazi. Gjithashtu edhe shoqërimet tingull – kuptim i kemi prezente në veprat e Kadaresë, të vendosura qëllimisht për të arritur efekte të ndryshme, kjo po që është një burim shprehësie. Qëllimi i përdorimit të elementeve stilistike ose përdorimit të stilemave të Kadareja i gjejmë herë për të ironizuar e herë për të përqeshur, e në disa raste edhe për ngjyrimë emocionale, por mbi të gjitha qëllimi i përdorimit të këtyre elementeve është gjuhëpastrimi dhe gjuhëpasurimi.

Si përfundim mund të themi që Kadareja në veprat e tij fjalët i ka përdorur në përshtatje me kontekstin dhe idenë duke i përshtatur siç është më së miri. Përveç kesaj, merita e madhe e Kadaresë është krijimi i fjalëve të reja dhe më e veçantë akoma ajo për të cilën i kushtuam rëndësi në këtë punim, stilistika e mjeteve fonetike dhe morfologjike. Krejt për fund do të thosha që ajo që i përshkon veprat e Kadaresë është edhe mbrojtja, pasurimi, zhvillimi dhe unifikimi i gjuhës standarde shqipe.

Referencat

- [1]. Dhrimo, Ali, *Mbiemrat në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2017.
- [2]. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
- [3]. Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995.
- [4]. Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, Tiranë, 2015.
- [5]. Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 2003.
- [6]. Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.
- [7]. Lloshi, Xhevat, *Vështrime stilistike*, Tiranë, 2021.
- [8]. Memisha, Valter, *Studime për fjalën shqipe II*, Tiranë, 2015.
- [9]. Thomaj, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974.
- [10]. Thomaj, Jani, *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.